

[Kthehu](#)

Instituti Statistikave, në kuadër të kryerjes së Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023 do të rekrutojë punonjës me kontratë shërbimi, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë për pozicionin:

**MBIKQYRËS IT**

shpërndarja e pozicioneve sipas bashkive, kliko këtu

(<https://www.instat.gov.al/media/11849/shperndarja-e-pozicioneve-sipas-bashkive-it.pdf>):

- Afati aplikimit: 07.08.2023
- Periudha e kontraktimit: 3.5 muaj (datat e trajnimit: 14.08.2023- 16.08.2023)
- Pagesa (bruto): 540 euro / muaj

**Detyrat:**

- Mbikqyrësi IT është i detyruar të ndjekë me përgjegjësi trajnimet që do të organizohen nga stafi INSTAT si dhe të studiojë manulet përkatëse
- Instalon, konfiguron, mirëmban tabletat/paisjet kompjuterike në përdorim nga stafi i terrenit;
- Mbështet dhe jep zgjidhje në lidhje me çështjet teknike për problematikat që ndesh stafi i terrenit (anketues/kontrollorë/mbikqyrës) nëpërmjet asistencës teknike;
- Mbikqyrësi IT duhet të ketë komunikim të vazhdueshëm me stafin e terrenit, Përfaqësuesit e INSTAT në nivel bashkie dhe Ekipit teknik TI të Censit;
- Trajnon anketuesit/kontrollorët për përdorimin e TI;
- Monitoron anketuesit/kontrollorët në përdorimin e infrastrukturën e TI sic duhet gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave;

**Kriteret e përzgjedhjes:**

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë përfunduar arsimin e mesëm. Avantazh përbëjnë studimet në shkenca kompjuterike /ose fusha të ngjashme;
- Preferohet të ketë eksperiencë në fushën e IT;
- Aftësi shumë të mira në përdorimin e pajisjeve kompjuterike, në mënyrë të veçantë tablet;
- Aftësia shumë të mira në instalimin, konfigurimin e tabletëve;
- Aftësi për të zgjidhur problemet e ndryshme software/hardware apo gabime njerëzore;
- Të jetë banues i bashkisë ku do të angazhohet në Cens.
- Të jetë bashkëpunues dhe të jetë i aftë të punojë në grup;
- Te ketë aftësi të mira komunikuese.

Copyright © 2023 Instituti i Statistikave